



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2876/ 2 prot.,

Datë 21.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Medfau” SHPK me Nipt J93610823R, me adresa: Lagjia Nr. 5, Kavajë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
Adresa: Bly. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Në datën 20.11.2023 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2023/3626, datë 20.11.2023, dhe me nr. 2876/2023 prot, datë 20.11.2023 e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar

për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Medfau” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Medfau” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2876/2023 prot., datë 20.11.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” i Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, nuk rezulton qe Paretet e mjetit duhet te jene me material anti-korrodues, sic kerkohet ne piken 11 Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike” te DST. Nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE nga ofertuesi, rezulton se, muret, tavani dhe dyshemeja se bashku me izolimin, jane bere nga materiale qe sigurojne respektimin e kerkesave te standarteve EN 1789 dhe EN ISO 3795, persa i perket ndezshmerise.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 21.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri